



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.179

dhjetor

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 361 datë 16.12.2010	Për një shtesë në ligjin nr.8530, datë 23.9.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar...	10045
Ligj nr.10 362 datë 16.12.2010	Për disa ndryshime në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.....	10045
Ligj nr.10 364 datë 16.12.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.....	10048
Ligj nr.10 365 datë 16.12.2010	Për një ndryshim në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	10049
Ligj nr.10 366 datë 16.12.2010	Për disa ndryshime në ligjin nr.9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar.....	10052
Vendim i Kuvendit nr.76, datë 27.12.2010	Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për transparencën e zgjedhjeve të përgjithshme, të mbajtura më 28 qershor 2009”	10054
Rezolutë e Kuvendit datë 27.12.2010	Për integrimin europian të Shqipërisë.....	10055
Vendim i KM nr.1057, datë 22.12.2010	Për shpronësimin shtesë, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan – Vlorë (seksioni i parë)....	10057
Vendim i KM nr.1058, datë 22.12.2010	Për kalimin e ish-shkollës së ulët të ndërtimit (3 kate) dhe ish-konviktit (4 kate), Shkozet, Durrës, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, për qëllim privatizimi.....	10059

Vendim i KM nr.1078, datë 29.12.2010	Për autorizimin e Kurum International, sh.a. për importin e mbretjeve metalike të hekurit dhe çelikut, për qëllime riciklimi.....	10066
Udhëzim i MMPAU nr.1065, datë 28.12.2010	Për kriteret e sipërfaqeve që mund të jepen në përdorim për rezervate të mbarështimit të llojeve të faunës së egër objekt gjetie, dokumentet që paraqet kërkuesi, procedurat e konkurrimit dhe rregullat e administrimit dhe gjetisë në këto sipërfaqe.....	10067
Vendim i GJK nr.37, datë 24.12.2010	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.279, datë 4.6.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë si të papajtueshëm me Kushtetutën	10071
Vendim i GJK nr.38, datë 30.12.2010	Me objekt shfuqizimin e vendimeve: nr.356, datë 28.6.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr.439, datë 3.12.2007 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr.518, datë 16.10.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi) si të papajtueshëm me Kushtetutën.....	10075
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Lulzim Tabaku.....	10081
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Alfred Emin Xherahi.....	10081

LIGJ
Nr.10 361, datë 16.12.2010

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8530, DATË 23.9.1999 “PËR SHËRBIMIN POSTAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8530, datë 23.9.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

Neni 1

Në nenin 8, pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Operatori publik postar ka të drejtë të hapë llogari rrjedhëse dhe depozitë pa interes pranë Bankës së Shqipërisë. Afatet dhe kushtet për hapjen dhe funksionimin e llogarisë e të depozitës do të përcaktohen në marrëveshjen përkatëse, lidhur ndërmjet operatorit publik postar dhe Bankës së Shqipërisë.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6834, datë 5.1.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

LIGJ
Nr.10 362, datë 16.12.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9072, DATË 22.5.2003 “PËR SEKTORIN E ENERJISË ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, pika 35/1 ndryshohet si më poshtë:

“35/1. Shkëmbimi, shitja dhe blerja e energjisë elektrike, në kuptim të këtij ligji, është marrëdhënia juridike ndërmjet palëve, sipas dispozitave përkatëse të Kodit Civil.”.

Neni 2

Në nenin 8 pika 2, shkronja “1” ndryshohet si më poshtë:

“1) miraton rregullat dhe procedurat, sipas të cilave bëhen shkëmbimi, blerja dhe shitja e energjisë elektrike nga dhe te furnizuesit/tregtarët vendas dhe të huaj.”.

Neni 3

Neni 51 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 51

Matja e energjisë elektrike të furnizuar

1. Energjia elektrike, e përdorur nga klienti, lexohet dhe faturohet sipas regjistrimeve të aparateve matëse.

2. Instalimi i aparateve matëse të energjisë elektrike bëhet në përputhje me Kodin e Matjes të energjisë elektrike, të miratuar nga ERE-ja.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) verifikon tipin e miratuar të aparatit matës të energjisë elektrike, kur futet për herë të parë në treg dhe/ose kur vendoset për herë të parë në përdorim (instalim). Ky verifikim mund të bëhet nga një subjekt/organ tjetër i autorizuar për këtë qëllim, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. DPM-ja njofton ERE-n lidhur me këtë autorizim. DPM-ja miraton procedurat e verifikimit të aparateve matëse të energjisë elektrike të vendosura në treg për herë të parë.

4. Morseteria e aparatit matës të energjisë elektrike bashkëvulose, pas instalimit te konsumatori, nga subjekti/organi i autorizuar dhe shpërndarësi me vula të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

5. DPM-ja në bashkëpunim me shpërndarësin dhe ERE-n, përcakton dokumentacionin e matjeve dhe kalendarin e kalimit të këtij dokumentacioni nga shpërndarësi te subjekti/organi i autorizuar.

6. Kalendarin e inspektimit për verifikimin e aparateve matëse dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Inspektimi periodik për verifikimin e saktësisë së matësve dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike, kolaudimit dhe vulosjes bëhet nga subjekte/organe të autorizuar. Organi i autorizuar informon DPM-në dhe shpërndarësin për inspektimin periodik.

8. DPM-ja informon periodikisht ministrinë dhe ERE-n për inspektimet periodike të kryera.

9. Subjekti/organi i autorizuar për verifikimin e tipit të miratuar të aparateve matëse të energjisë elektrike, kur vendosen në treg përherë të parë dhe/ose në përdorim (instalim), dhe subjekti/organi i autorizuar për inspektimin periodik për verifikimin e saktësisë së aparateve matëse dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike, të kolaudimit, të vulosjes, si dhe të mirëmbajtjes së tyre, rregullojnë marrëdhëniet e tyre me shpërndarësin, sipas një kontrate tip, të propozuar nga DPM-ja dhe të miratuar nga ERE-ja.

10. Kur konsumatori dyshon në saktësinë e një matësi, ose kur ka vënë re pasaktësi në matës, bën kërkesë me shkrim te DPM-ja dhe/ose çdo organ tjetër për mbrojtjen e konsumatorit. DPM-ja është përgjegjëse për verifikimin e saktësisë së aparatit matës të energjisë elektrike, i cili kontrollohet nga DPM-ja ose një subjekt/organ i autorizuar, me kushtin që ky i fundit nuk është

përfshirë më parë në verifikimin e saktësisë së këtij matësi. Kur pas kontrollit vërehen pasaktësi në matës, shpenzimet për riparimin apo zëvendësimin e tij, si dhe shpërblimi i dëmit të shkaktuar për këtë shkak janë në ngarkim të subjektit që ka shkaktuar dëmin. Shpërblimi i këtij dëmi bëhet sipas Kodit të Matjes dhe dispozitave të Kodit Civil.

Kur nuk vihet re ndonjë pasaktësi, shpenzimet e kontrollit paguhen nga ankuesi.

Procedura e paraqitjes së ankesës, mënyra e shqyrtimit të saj dhe afati i njoftimit të ankuesit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

11. Në rast të një mosmarrëveshjeje ndërmjet shpërndarësit dhe subjektit/organit të autorizuar, që lidhet me zbatimin e procedurave standarde të verifikimit, autorizohet DPM-ja të vendosë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, për të cilën njofton ministrinë dhe ERE-n.

12. Tarifat për shërbimet e ofruara nga subjekti/organi autorizuar, në bazë të nenit 40 të ligjit nr.9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, të ndryshuar, miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të ministrit përgjegjës për ekonominë. Në relacionin shoqërues të këtij udhëzimi, DPM-ja dhe ERE-ja shprehin opinionin e tyre për tarifën e propozuar për miratim. ERE-ja merr parasysh koston e këtyre tarifave për të licencuarit në përcaktimin e çmimeve dhe të tarifave të energjisë elektrike.

13. Në sistemin e matjes së energjisë elektrike ndërhyt vetëm subjekti/organi i autorizuar, i cili, pas verifikimit, e vulos atë me vulë të miratuar nga DPM-ja. Vulosja duhet të bëhet pas çdo verifikimi të kryer nga subjekti/organi i autorizuar vetëm në prani të shpërndarësit.

14. Llogaritja e dëmit ekonomik, shkaktuar kompanisë nga çdo ndërhyrje e paligjshme, bëhet në përputhje me metodologjinë përkatëse të miratuar nga ERE-ja.

Neni 4

Në nenin 65/1, fjalët “shkëmbimi dhe shitja” zëvendësohen me fjalët “shkëmbimi, shitja dhe blerja”.

Neni 5

Dispozita kalimtare

1. Kalimi i dokumentacionit të matjeve nga shpërndarësi te subjekti/organi i autorizuar duhet të fillojë me hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe ky proces duhet të zgjasë jo më shumë se 6 muaj.

2. Në rast të tejkalimit të këtij afati, personi përgjegjës paguan dëmin e shkaktuar, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Deri në nxjerrjen e vendimit të Këshillit të Ministrave, inspektimi periodik do të kryhet në përputhje me Kodin e Matjes.

Neni 6

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6835, datë 5.1.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 364, datë 16.12.2010

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998 “PËR
TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 8/1 “Të ardhura të përjashtuara”, pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:
“8. Kontributet e bëra nga punëdhënësi për sigurimin e jetës dhe të shëndetit të punëmarrësve.”.

Neni 2

Në fund të nenit 20 “Shpenzime të njohura” shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
“Shpenzimet e sigurimit të jetës dhe të shëndetit të punëmarrësve nga punëdhënësi konsiderohen si shpenzime të njohura.”.

Neni 3

Neni 25 “Rezervat speciale për bankat dhe shoqëritë e sigurimit” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25

Rezervat speciale për bankat dhe shoqëritë e sigurimit

Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të bankave dhe të shoqërive të sigurimit janë shpenzime të njohura rezervat teknike, të krijuara në përputhje me ligjin “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe provizionet e bankave, të krijuara në përputhje me standardet e hartuara nga Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtare dhe të certifikuara pa vërejtje nga auditues të jashtëm, por, në çdo rast, pa tejkaluar masën e përcaktuar në rregullat e Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim. Shumat e rimarra nga këto rezerva apo provizione i shtohen fitimit të tatueshëm.”.

Neni 4

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Pjesëmarrjet që përjashtohen nga tatimi mbi fitimin

Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të një personi rezident përjashtohen, si të ardhura, dividendët dhe ndarjet e fitimit, kur ato shpërndahen nga shoqëritë e ortakëritë rezidente dhe shoqëritë jorezidente të huaja, që janë subjekte të tatimit mbi fitimin, pavarësisht nga kuota e

pjesëmarrjes, në vlerë ose në numër, të kapitalit aksionar, të së drejtës së votës apo të pjesëmarrjes në kapitalin fillestar apo aksionar të përfituesit.”.

Neni 5

Në nenin 30 “Parapagimet”, pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Në rastin kur tatimpaguesi, në çdo kohë, gjatë periudhës tatimore, vërteton para organeve tatimore se tatimi mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi mbi fitimin në periudhën paraardhëse ose periudhën e dytë paraardhëse, atëherë organet tatimore pranojnë zvogëlimin e parapagimeve, sipas rregullave të vendosura nga Ministria e Financave. Në rast se subjekti taksapagues ka ulur këstet e parapagimit, të caktuara nga organi tatimor, dhe detyrimi tatimor vjetor për tatimfitimin, që rezulton nga bilanci, tejkalon parapagimin me më shumë se 10 për qind, subjekti duhet të paguajë interes mbi diferencën ndërmjet detyrimit real vjetor dhe shumës së parapaguar gjatë vitit, sipas rregullave të vendosura nga Ministria e Financave.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6837, datë 5.1.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.10 365, datë 16.12.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8976, DATË 12.12.2002 “PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Shtojca 1 që i bashkëlidhet ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6838, datë 5.1.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

SHTOJCA NR.1

MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Kodi NK	Përshkrimi	Shkalla tatimore
I	KAFE	
09 01 11 00 09 01 12 00	Kafe jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	30 lekë/kg
09 01 21 00 09 01 22 00	Kafe e pjekur e dekafeinizuar ose jo	140 lekë/kg
09 01 90	Lëkura dhe lëvoret e kafesë. Zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe	50 lekë/kg
21 01 11 21 01 12	Ekstrakte, esenca, koncentrate kafeje dhe përgatitje prej tyre (neskafe etj.)	250 lekë/kg
II	BIRRË, VERË, ALKOOL DHE PIJE ALKOOLIKE	
22 03	Birrë e bërë nga malto - nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 200 000 hektolitër/vit - nga prodhues vendas e të huaj me sasi > 200 000 hektolitër/vit	30 lekë/litri 40 lekë/litri
22 04	Verë dhe verërat e gazuara; shampanjë; musht rrushi - nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 10 000 hektolitër/vit - nga prodhues vendas e të huaj me sasi > 10 000 hektolitër/vit	20 lekë/litri 35 lekë/litri
22 05	Vermut e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese -nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 300 hektolitër/vit -nga prodhues vendas e të huaj me sasi > 300 hektolitër/vit	20 lekë/litri 35 lekë/litri
22 06	Të tjera pije të fermentuara (p.sh. cider, cider dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të papërmendura diku tjetër	20 lekë/litri
22 07 10 00	Alkool etilik jo i denatruar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80 për qind ose më tepër	400 lekë/litri
22 007 20 00	Alkool etilik i denatruar	0
22 08	Pije alkoolike me forcë alkoolike ndaj volumit mbi 12 për qind -nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 20 000 hektolitër/vit -nga prodhues vendas e të huaj me sasi > 20 000 hektolitër/vit	220 lekë/litri 300 lekë/litri
	Pije alkoolike me forcë alkoolike ndaj volumit deri në 12 për qind	100 lekë/litri
22 08 20 29	Raki	100 lekë/litri
III	DUHAN DHE NËNPRODUKTET E TIJ	
24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan	2 500 lekë/kg

24 02 20	Cigare që përmbajnë duhan	70 lekë/paketa
24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	2 240 lekë/kg
24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit, duhan i homogjenizuar ose i rindërtuar, ekstrakte dhe esenca prej duhani	1 500 lekë/kg
IV	NËNPRODUKTET E NAFTËS	
27 10 11 11	Naftë që kërkon një proces specifik përpunimi	50 lekë/litri
27 10 11 41	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol) Benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013 gr/litër	37 lekë/litri
27 19 11 45	Me më pak se 95 oktan	
27 10 11 49	Me 98 e më shumë oktan	
27 10 11 51	Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër	50 lekë/litri
27 10 11 59	Me më pak se 98 oktan	
27 10 11 59	Me 98 e më shumë oktan	
27 10 19 11 deri 27 10 19 29	Vajgurët	20 lekë/litri
27 10 19 21	Karburantet, tip vajguri	20 lekë/litri
27 10 19 31 deri 27 10 19 49	Vajra të rënda (gazoil)	37 lekë/litri
27 10 19 51 deri 27 10 19 69	Vajra të rënda si lëndë djegëse (lëndë djegëse, solar, mazut)	20 lekë/kg
27 10 19 71 deri 27 10 19 99	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera	40 lekë/kg
27 13 11 00 27 13 12 00	Koks naftë dhe vajra të tjera	1 lek/kg
27 13 20 00	Bitum naftë	5 lekë/kg
27 13 90	Mbetje të vajrave të naftës dhe të mineraleve bituminoze (bitumen)	5 lekë/kg
27 14 90 00	- Të tjera (bitum dhe asfalt natyror; asfaltet dhe gurët asfaltikë)	5 lekë/kg
27 15	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyror, në bitumen e naftës, në katranin mineral, ose në terpeninën e katranit mineral (mastiçet bituminoze) Vernik bituminoz	5 lekë/kg 5 lekë/kg
29 01 29 02	Hidrokarbure aciklike dhe ciklike, përfshirë (etilen, benzen, toluol, ksilol)	37 lekë/kg
34 03 19 91 34 03 99 10	Preparate për lubrifikimin e makinerive, pajisjeve dhe automjeteve	40 lekë/kg
V	FISHEKZJARRËT	
36 04 10 00	Fishekzjarrët	200 lekë/kg
36 04 90 00	Të tjera	200 lekë/kg

VI	GOMAT	
40 11	Goma të reja pneumatike prej gome	20 lekë/kg
40 12 (përveç 40 12 20 00)	Goma pneumatike të riveshura; goma mishi apo të zakonshme; veshja e jashtme (pjesa me lule) dhe fashetat e gomës	40 lekë/kg
40 12 20 00	Goma pneumatike të përdorura	100 lekë/kg
VII	PILAT DHE BATERITË PRIMARE; AKUMULATORËT ELEKTRIKË	
85 06	Pilat dhe bateritë primare	200 lekë/kg
85 07	Akumulatorët elektrikë, përfshi ndarëset e tyre, nëse janë apo jo drejtkëndëshe (përfshi katrorët)	20 lekë/kg
VIII	AMBALAZHET	
	AMBALAZHET: Ambalazhet e plastikës Ambalazhet e qelqit Ambalazhi i përzier	100 lekë/kg 10 lekë/kg 20 lekë/kg
IX	LLAMBA INKANDESHENTE	
85 39 22 10	Llambat reflektor	100 lekë/copa
85 39 22 90	Të tjera	100 lekë/copa
85 39 29 92	Më tepër se 100 V	100 lekë/copa
85 39 29 98	Jo më tepër se 100 V	100 lekë/copa

LIGJ

Nr.10 366, datë 16.12.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9981, DATË 8.9.2008 “PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Nivelet tarifore të disa artikujve, të përcaktuar në lidhjen nr. 1 të ligjit nr. 9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar, ndryshojnë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ndalohet importimi në Republikën e Shqipërisë i mbeturinave urbane me kod doganor 38251000, llumrave të ujërave të zeza me kod doganor 38252000 dhe mbeturinave klinike me kode doganore 38253000, 38254100 dhe 38254900.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6839, datë 5.1.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

ANEKSI 1

Kodi NK 2010	Përshkrimi	Tarifa ishte (%)	Tarifa bëhet (%)
02062200	Mëlçi	10	5
02063000	Prej derri, i freskët apo i ftohur	10	5
02064100	Mëlçitë	10	5
02064900	Të tjera	10	5
07081000	Bizele (Pisum sativum) (nga 1 qershori deri 31 gusht)	15	10
08061090	Të tjera (nga 1 janari deri 14 korrik)	10	5
08061090	Të tjera (nga 1 nëntori deri 31 dhjetor)	10	5
09041100	As i bluar as i grirë	15	10
09042030	Të tjera	15	10
09093000	Farat e barit të gjumit	15	10
09094000	Farat e qimnonit	15	10
09095000	Farat e koprës, fara dëllinje	15	10
09101000	Xenxerfill	15	10
28520000	Përbërje inorganike dhe organike të mërkurit, duke përfshirë amalgamet	2	0
35071000	Mullez dhe koncentratet e tij	10	6
35079030	Lipaze lipoproteine; proteaze alkaline prej aspergillus	10	6
35079090	Të tjera	10	6
36041000	Fishekzjarrët	15	6
36049000	Të tjera	15	6
36050000	Shkrepëset, përveç artikujve piroteknikë të kreut 3604	15	6
38210000	Mjedis i përgatitur për kulturat për zhvillimin apo mirëmbajtjen e mikroorganizmave (përfshi viruset dhe të ngjashmet) ose qelizave të bimëve, njeriut apo kafshëve	2	0
38251000	Mbeturinat urbane	2	0
38252000	Llumrat e ujërave të zeza	2	0
38253000	Mbeturinat klinike	2	0
38254100	Të halogjenizuar	2	0
38254900	Të tjera	2	0
38255000	Mbeturina të lëngjeve pastruese të metaleve, lëngjeve hidraulike, lëngjeve të frenave dhe antifrizet	2	0
38256100	Që përmbajnë kryesisht përbërës organikë	2	0

38256900	Të tjera	2	0
38259090	Të tjera	2	0
44219091	Prej panele fibrash	10	0
44219098	Të tjera	10	0
68128010	Fibra të fabrikua; përzierje me një bazë të asbestit apo me një bazë të asbestit dhe të karbonatit të magnezit	15	10
68128090	Të tjera	15	10
68129910	Fibra të fabrikua asbesti; përzierje me një bazë asbesti apo me një bazë asbesti dhe karbonat magnezi	15	10
68129990	Të tjera	15	10
73066192	Me një trashësi muresh jo më tepër se 2 mm	5	0
73066199	Me një trashësi muresh më tepër se 2 mm	5	0
73066990	Të tjera	5	0
84672110	Që funksionojnë pa një burim të brendshëm energjie	2	0
84672191	Elektropneumatike	2	0
84672199	Të tjera	2	0
84672210	Sharra elektrike me zinxhirë	2	0
84672230	Sharrë disk	2	0
84672290	Të tjera	2	0
84701000	Kalkulatorët elektronikë, të aftë të veprojnë pa një burim të jashtëm fuqie elektrike dhe makina të përmasave të xhepit regjistruese, riprodhuese dhe shfaqjeje të dhënave me funksione kalkuluese	2	0
85193000	Gramafonet	10	0
85489090	Të tjera	2	0
90069900	Të tjera	10	0
99000000	Mallra të udhëtarëve jo të një natyre tregtare	-	2

VENDIM
Nr.76, datë 27.12.2010

PËR MOSMIRATIMIN E PROJEKTVENDIMIT “PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR TRANSPARENCËN E ZGJEDHJEVE TË PËRGJITHSHME, TË MBAJTURA MË 28 QERSHOR 2009”

Në mbështetje të nenit 78 pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për transparencën e zgjedhjeve të përgjithshme, të mbajtura më 28 qershor 2009”, për shkaqet e

paraqitura në raportin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

REZOLUTË PËR INTEGRIMIN EUROPIAN TË SHQIPËRISË

Duke rikonfirmuar vullnetin e Kuvendit të Shqipërisë se procesi i integrimit evropian përbën objektivin madhor politik për Shqipërinë dhe shqiptarët;

Duke vlerësuar progresin e madh dhe të padiskutueshëm të Republikës së Shqipërisë në kontekstin e proceseve reformuese dhe përparimet në rrugën e integrimit evropian, konsolidimin e shoqërisë demokratike, shtetit të së drejtës, luftës ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, të cilat sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm demokratik të vendit;

Duke vlerësuar se Republika e Shqipërisë është një demokraci funksionale, sipas standardeve dhe praktikave evropiane dhe, ndër vite, ajo ka bërë progres në përmbushjen e kriterëve që kanë të bëjnë me stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut dhe respektimit e mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve, të njohura si kriteret e Kopenhagenit, 1993 dhe, njëkohësisht, edhe kriteret e procesit të stabilizim–asocimit;

Duke ritheksuar se, në kontekstin e integrimit evropian të Shqipërisë, zgjedhjet e 28 qershorit 2009 përbëjnë një sukses të qenësishëm për Shqipërinë, të cilat përmbushën shumicën e standardeve ndërkombëtare në fushën e zgjedhjeve dhe janë vlerësuar si të tilla nga raporti përfundimtar i OSCE/ODIHR-it;

Duke vlerësuar se liberalizmi i vizave përbën një arritje historike për shtetin dhe popullin shqiptar, që u mbështet në proceset e suksesshme, të gjithanshme, reformuese të shtetit shqiptar, si dhe duke shprehur mirënjohjen ndaj vendeve të Bashkimit Evropian për gatishmërinë dhe vlerësimin e bërë;

Duke vlerësuar zhvillimin e shpejtë të ekonomisë së tregut në Shqipëri, reformën rregullatore për sigurimin e një klime sa më miqësore dhe favorizuese ndaj biznesit, luftën ndaj monopoleve dhe reduktimin e ekonomisë informale, transparencën dhe luftën ndaj korrupsionit, rritjen e performancës së administratës tatimore dhe zhvillimin e fuqishëm të investimeve të huaja në Shqipëri;

Duke vlerësuar maksimalisht konsensusin e gjerë mes forcave politike për destinacionin evropian të Shqipërisë, si dhe mbështetjen e gjerë popullore në vend për integrimin evropian;

Duke mbështetur rolin e Republikës së Shqipërisë në konsolidimin e bashkëpunimit rajonal, rolin konstruktiv dhe promotor në politikat rajonale të bashkëpunimit dhe fqinjësisë së mirë dhe më gjerë;

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

1. **Çmon** se opinioni i Komisionit Evropian dhe Raporti Analitik, 2010 i Komisionit Evropian duhet të përbëjë programin e punës për çdo institucion në Republikën e Shqipërisë dhe duhet të përkthet në objektiva konkrete dhe të prekshëm për përmirësimin e punës dhe performancës së çdo institucioni, për të sjellë në një stad të ri rrugën e zhvillimit dhe të integrimit evropian të Shqipërisë.

- Komisionet e përhershme të Kuvendit, në vlerësimin e punës vjetore të institucioneve të pavarura, duhet të zhvillojnë debat të zgjeruar për performancën e tyre, në raport me konstatimet e Raportit Analitik dhe, në programimin e objektivave të punës për vitin 2011, të reflektojnë kërkesat e paraqitura në raport;

- Kalendar i objektivave të punës së çdo institucioni, i hartuar sipas pikës 1, duhet të bëhet publik dhe opinioni publik duhet të informohet për veprimet e ndërmarra nga çdo institucion në përmbushjen e tij.

2. **Gjykon** se mosfunksionimi normal i raportit pozitë-opozitë dëmton mbarëvajtjen dhe ushtrimin e plotë të kompetencave kushtetuese të Kuvendit. Në mënyrë të veçantë, bojkoti dhe braktisja e debateve, mbledhjeve dhe votimeve në Kuvend penalizon realizimin e objektivave dhe zvarrit proceset integruese dhe europianizuese të vendit. Për pasojë, Kuvendi bën thirrje për ndryshimin rrënjësor të këtyre praktikave të dëmshme dhe joproduktive.

3. **Për të nxitur dhe konsoliduar** frymën e bashkëpunimit dhe kompromisit të qëndrueshëm shumicë-opozitë, Kuvendi i bën thirrje opozitës parlamentare të mbajë përgjegjësitë e kohës europiane për Shqipërinë, duke vendosur interesat kombëtarë mbi ata partiakë, për:

- Miratimin në një kohë sa më të shpejtë, të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it;

- Realizimin e zgjedhjeve të ardhshme vendore, në përputhje me standardet europiane dhe ato ndërkombëtare;

- Zgjedhjen sa më shpejt të Avokatit të Popullit në Kuvend;

- Votimin e ligjeve që kërkojnë një shumicë të cilësuar në Kuvend;

- Marrjen e masave të nevojshme legjislativë për të kufizuar numrin e organeve që kanë imunitet dhe kufizimin e aplikimit të imunitetit për zyrtarët e lartë shtetërorë.

4. **Nxit, mbështet dhe kërkon:**

- Intensifikimin e përpjekjeve legjislativë, buxhetore, administrative dhe institucionale, si një prioritet strategjik, për të fituar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, nëpërmjet një drejtësie të pavarur, transparente, të përgjegjshme dhe eficiente. Strategjia e reformës në drejtësi të përfundojë në një afat sa më të shkurtër dhe të shërbejë si baza solide e konsolidimit dhe harmonizimit të përpjekjeve të përbashkëta, për të mundësuar një drejtësi të standardeve europiane në Shqipëri. Strategjia të shërbejë dhe të realizojë reformimin e sistemit në dy shtylla kryesore: pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e tij;

- Hyrjen në një fazë të re të luftës ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke implementuar me saktësi dhe profesionalizëm bazën e re legjislativë në këtë fushë dhe duke rritur bashkëpunimin polici-prokurori-gjyqësor, për të përmbushur këtë objektiv të përbashkët dhe themelor për një shoqëri demokratike;

- Paraqitjen sa më shpejt të amendamenteve të ligjit “Statusi i nëpunësit civil”, me synim konsolidimin e një administrate civile profesionale, të aftë të përballojë zhvillimet e vendit dhe të konsolidojë rolin e saj si një aset i çmuar i organizimit shtetëror të Shqipërisë;

- Miratimin mbi ekspertizën profesionale dhe të një konsultimi të gjerë të strategjisë për të drejtat e pronësisë në Shqipëri, e cila duhet të përfshijë edhe zbatimin në të drejtën e brendshme, në kuptimin legjislativ të vendimeve të Gjykatës së Strasburgut me palë Republikën e Shqipërisë, por edhe në përgjithësi jurisprudencën e kësaj Gjykate për të drejtat e pronësisë;

- Marrjen e masave konkrete dhe të gjithanshme, nga çdo aktor dhe autoritet, për mbrojtjen adekuate të të drejtave dhe lirive të njeriut, përfshirë trajtimin e të burgosurve dhe të paraburgosurve, të grave, të të miturve, luftë efektive dhe më cilësore për dhunën në familje, me theks të veçantë në parandalimin e saj, si dhe zbatimin e plotë të legjislacionit të detajuar për antidiskriminimin.

27 dhjetor 2010

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.1057, datë 22.12.2010

**PËR SHPRONËSIMIN SHITESË, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR LEVAN – VLORË (SEKSIONI I PARË)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin shtesë, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan – Vlorë (seksioni i parë).
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet sipas listave bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqe 74 167m² tokë arë, vlerësuar me çmimet e konfirmuara nga AKKP-ja, me vlerë 32 031 605 (tridhjetë e dy milionë e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesë) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 32 031 605 (tridhjetë e dy milionë tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesë) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.
 6. Shpronësimi të fillojë më 30.12.2010 dhe të përfundojë më 30.5.2011.
 7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, si dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.
 10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
 11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
 DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN SI REZULTAT I NDERTIMIT TE SEGMENTIT RRUGOR LEVAN - VLORE
 SEKSIONI I PARË

NR.	PRONARI			NR. PAS.	SIP. M ²	ÇMIMI LEKE/M ²	VLERA LEKË	SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri					
LEVAN (Z.K 2436)								
1	LEFTER	SHEFQET	TUSHOLLARI	538/24	175	335	58625	Konfirmuar nga ZRPP
2	ENVER	SHEFQET	TUSHOLLARI	538/23	24	335	8040	Konfirmuar nga ZRPP
3	RAMADAN	RRAPI	MERSINI	538/19	665	335	222775	Konfirmuar nga ZRPP
4	OSMAN	RRAPI	MERSINI	538/18	340	335	113900	Konfirmuar nga ZRPP
5	RRAPI	REXHEP	KALEMAJ	538/17	213	335	71355	Konfirmuar nga ZRPP
6	PILO	NAZIF	MYRTELI	538/16	646	335	216410	Konfirmuar nga ZRPP
7	HALIT	ZYBER	HAMZA	538/15	863	335	289105	Konfirmuar nga ZRPP
8	LAVER	BEXHET	MYRTELI	538/14	970	335	324950	Konfirmuar nga ZRPP
9	MYQEREM	ZYBER	HAMZO	538/13	920	335	308200	Konfirmuar nga ZRPP
10	KOVAC	RIZA	TUSHOLLARI	538/12	764	335	255940	Konfirmuar nga ZRPP
11	FADIL	RIZA	TUSHOLLARI	538/11	838	335	280730	Konfirmuar nga ZRPP
12	MYNYR	RIZA	TUSHOLLARI	538/10	777	335	260295	Konfirmuar nga ZRPP
13	MALIQ	RAMADAN	MYRTELI	538/9	589	335	197315	Konfirmuar nga ZRPP
14	MYQEREM	BEKTASH	KAZANXHI	538/8	1063	335	356105	Konfirmuar nga ZRPP
15	TOMOR	BARJAM	RRAPAJ	538/6	290	335	97150	Konfirmuar nga ZRPP
16	SABAH	JAKUP	MUCAJ	538/5	1001	335	335335	Konfirmuar nga ZRPP
17	ELIDA	TOMCI	NACI	538/4	204	335	68340	Konfirmuar nga ZRPP
18	ARJAN	LUCI	REZHDO	538/1	454	335	152090	Konfirmuar nga ZRPP
19	RAKO		NAKO	538/42	255	335	85425	Konfirmuar nga ZRPP
20	LEONARD	RAKO	NAKO	538/43	1215	335	407025	Konfirmuar nga ZRPP
21	AGRON	RAKO	NAKO	538/44	841	335	281735	Konfirmuar nga ZRPP
22	VLADIMIR	ISMAIL	KAMBERAJ	538/45	714	335	239190	Konfirmuar nga ZRPP
23	QEMAL	SHEFIT	HOXHA	538/52	948	335	317580	Konfirmuar nga ZRPP
24	AFERDITA	YMER	BREGU	538/53	1509	335	505515	Konfirmuar nga ZRPP
25	PIETRO	HYSEN	YZEIRI	538/54	287	335	96145	Konfirmuar nga ZRPP
26	DHIMO		PURIQI	120/19	591	335	197985	Konfirmuar nga ZRPP
27	SULO	BESHO	SULAJ	121/14	336	335	112560	Konfirmuar nga ZRPP
28	BANUSH	VESEL	SULAJ	121/16	889	335	297815	Konfirmuar nga ZRPP
29	HETEM		SULAJ	121/17	143	335	47905	Konfirmuar nga ZRPP
30	KASTRIOT	SKENDER	SULAJ	121/22	2070	335	693450	Konfirmuar nga ZRPP
31	ASTRIT		SULAJ	121/23	2545	335	852575	Konfirmuar nga ZRPP
32	ALEKSANDER		LLAMBRO	122/14	649	335	217415	Konfirmuar nga ZRPP
33	LILJANA	YMER	METAJ	127/23	438	335	146730	Konfirmuar nga ZRPP
34	SHYQYRI	SEFEDIN	MALAJ	127/16	441	335	147735	Konfirmuar nga ZRPP
35	FEJZI	RUSHIT	BIBO	127/15	276	335	92460	Konfirmuar nga ZRPP
36	RUSHIT	HIZER	BIBO	127/14	561	335	187935	Konfirmuar nga ZRPP
37	ARTA		THOMO	127/25	303	335	101505	Konfirmuar nga ZRPP
38	SHERIF		RUSTEMI	127/10	383	335	128305	Konfirmuar nga ZRPP
39	NAZAR	MUHAMET	VELI	127/9	394	335	131990	Konfirmuar nga ZRPP
40	JEMIN	MUHAMET	VELI	127/7	312	335	104520	Konfirmuar nga ZRPP
41	MUSA		VELI	127/6	330	335	110550	Konfirmuar nga ZRPP
42	ALEKS		DULAJ	143/3	61	335	20435	Konfirmuar nga ZRPP
43	NAZMI		COBO	143/1	808	335	270680	Konfirmuar nga ZRPP
44	TAJAR		COBO	142/1	844	335	282740	Konfirmuar nga ZRPP
45	ASQERI		COBO	142/2	407	335	136345	Konfirmuar nga ZRPP
46	MBARIME		COBO+B	142/4	702	335	235170	Konfirmuar nga ZRPP
47	NAZMI		LANI	130/20	77	335	25795	Konfirmuar nga ZRPP
48	NAZMI		LANI	130/21	10	335	3350	Konfirmuar nga ZRPP
49	STAVRI		KORDHA	129/25	171	335	57285	Konfirmuar nga ZRPP
50	FADIL	GANI	JAUPAJ	129/22	1494	335	500490	Konfirmuar nga ZRPP
51	SERVET		CAUSHAJ	412/13	24	335	8040	Konfirmuar nga ZRPP
52	NAZMI		AHMETAJ	412/14	690	335	231150	Konfirmuar nga ZRPP
53	SKENDER		CAUSHAJ	412/25	367	335	122945	Konfirmuar nga ZRPP
54	GJOLEK		CAUSHAJ	412/26	703	335	235505	Konfirmuar nga ZRPP
55	DURIM		CAUSHAJ	412/27	679	335	227465	Konfirmuar nga ZRPP
56	RAMIZ		ZYKA	412/16	2478	335	830130	Konfirmuar nga ZRPP
57	BAFTJAR		VEIZAJ	412/17	1969	335	659615	Konfirmuar nga ZRPP
58	NEZIR		VEIZAJ	412/18	3070	335	1028450	Konfirmuar nga ZRPP
59	ADIL		VEIZAJ	412/19	1493	335	500155	Konfirmuar nga ZRPP
60	ENVER	XHAFER	BALLA	412/20	250	335	83750	Konfirmuar nga ZRPP
61	PERPARIM		LAMAJ	411/6	156	335	52260	Konfirmuar nga ZRPP
62	VIKTOR		BUXHAJ	413/13	40	335	13400	Konfirmuar nga ZRPP
63	JOVAN		RISTA	413/10	971	335	325285	Konfirmuar nga ZRPP
64	MINA	LONI	RISTA	413/9	1105	335	370175	Rikonfirmim nga ZRPP
65	LLAMBRI		RISTA	413/8	82	335	27470	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI			45877		15368795	
		FERRAS	(Z.K. 1609)					
66	ZANI	SABRI	HYKA	24/34	7	589	4123	Konfirmuar nga ZRPP
67	SABRI	SHABAN	HYKA	24/33	33	589	19437	Konfirmuar nga ZRPP
68	XHEVAT	SHABAN	HYKA	24/32	142	589	83638	Konfirmuar nga ZRPP
69	SHEFQET		HYKA	24/31	167	589	98363	Konfirmuar nga ZRPP
70	NAMIK		HYKA	24/30	184	589	108376	Konfirmuar nga ZRPP
71	FETI	SALI	HYKA	24/29	216	589	127224	Konfirmuar nga ZRPP
72	JASHAR		HYKA	24/28	266	589	156674	Konfirmuar nga ZRPP
73	NIMETE		NANI	24/26	295	589	173755	Konfirmuar nga ZRPP
74	ALEKSANDER		NANI	24/25	360	589	212040	Konfirmuar nga ZRPP

75	SEFIRE		NANI	24/24	273	589	160797	Konfirmuar nga ZRPP
76	RIZA	BELUL	NANI	24/23	620	589	365180	Konfirmuar nga ZRPP
77	ISUF		NANI	24/22	474	589	279186	Konfirmuar nga ZRPP
78	RAMADAN		NANI	24/21	486	589	286254	Konfirmuar nga ZRPP
79	PELLUMB		NANI	24/20	467	589	275063	Konfirmuar nga ZRPP
80	RAMIZ		NANI	24/19	463	589	272707	Konfirmuar nga ZRPP
81	VLADIMIR		NANI	24/18	276	589	162564	Konfirmuar nga ZRPP
82	GEZIM		NANI	24/17	455	589	267995	Konfirmuar nga ZRPP
83	ASTRIT		NANI	24/16	247	589	145483	Konfirmuar nga ZRPP
84	NESHAT	SULO	BANA	24/14	223	589	131347	Konfirmuar nga ZRPP
85	SHERO	RIZA	TROKA+B	24/13	250	589	147250	Konfirmuar nga ZRPP
86	MITI		MOCKA	24/11	89	589	52421	Konfirmuar nga ZRPP
87	KOVAC		BANA	24/10	165	589	97185	Konfirmuar nga ZRPP
88	MELEQ		BANA	24/9	38	589	22382	Konfirmuar nga ZRPP
89	ANDREA		SEMA	23/5	579	589	341031	Konfirmuar nga ZRPP
90	FANIE		SEMA	23/3	1547	589	911183	Konfirmuar nga ZRPP
91	ARSINI		SEMA	43/13	1573	589	926497	Konfirmuar nga ZRPP
92	VANGJEL		SEMA	43/12	5636	589	3319604	Konfirmuar nga ZRPP
93	KOZMA		SEMA	43/11	12	589	7068	Konfirmuar nga ZRPP
94	NDONI	THEMI	PETANI	44/2	690	589	406410	Konfirmuar nga ZRPP
95	SOKRAT		PETANI	44/3	6361	589	3746629	Konfirmuar nga ZRPP
96	KRISTAQ	SOTIR	PETANI	44/4	1715	589	1010135	Konfirmuar nga ZRPP
97	VASIL		SEMA+B	221/7	3981	589	2344809	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI			28290		16662810	
		TOTALI			74167		32031605	

VENDIM
Nr.1058, datë 22.12.2010

PËR KALIMIN E ISH - SHKOLLËS SË ULËT TË NDËRTIMIT (3 KATE) DHE ISH - KONVIKTIT (4 KATE), SHKOZET, DURRËS, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, PËR QËLLIM PRIVATIZIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 10, 11 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e objektit të ish - Shkollës së Ulët të Ndërtimit (3 kate), me vendndodhje në zonën kadastrale nr.8515, Shkozet, Durrës, të ish - konviiktit (4 kate) të saj, në zonën kadastrale nr.8516, në Shkozet, Durrës, dhe të truallit nën objekte, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, sipas genplanit dhe planimetricave bashkëlidhur, me qëllim privatizimin, në favor të banorëve të pastrehë, të persekutuar politikë, sipas listës bashkëlidhur, të cilët banojnë në këto godina, të 44 (dyzet e katër) apartamenteve, të përshtatura nga viti 1995.

2. Ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave, që, pas kalimit në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave dhe regjistrimit të tyre në ZRPP, në emër të Entit, të bëjë privatizimin e tyre, gjithsej, 44 apartamente, për familjet e personave të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, sipas procedurave që përcaktohen me udhëzimin nr.19, datë 13.9.2007 të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. Procedurat e privatizimit të apartamenteve dhe lidhja e kontratës të bëhen brenda 1 (një) viti nga data e regjistrimit në favor të Entit Kombëtar të Banesave. Në rast se personi sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, nuk paraqitet pranë EKB-së të lidhë kontratën brenda afatit 1-vjeçar, familjes i humbet e drejta e privatizimit dhe objekti duhet të përdoret nga Enti Kombëtar i Banesave në zbatim të programit të banesave sociale me kosto të ulët.

4. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Enti Kombëtar i Banesave dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHKOLLA 3-KATËSHE SHKOZET, DURRËS

Nr	Emri, atësia,mbiemri	Struktura	Shënime
1	Myzafer Fuat Kulla	2+1	Kati I
2	Shefqet Bajram Baçani	2+1	Kati I
3	Petrit Dyl Allamani	2+1	Kati II
4	Nexhmi Jaçe Vrioni	2+1	Kati II
5	Shaban Osman Millaqi	2+1	Kati II
6	Rexhep Zenel Gojana	2+1	Kati III
7	Ferik Mezan Jonuzi	2+1	Kati I
8	Enver Ismail Haxhia	2+1	Kati I
9	Vasiliqi Anastas Garuli	3+1	Kati I
10	Maksim Xhaferr Rakipaj	2+1	Kati II
11	Idriz Hamdi Kaiku	2+1	Kati II
12	Gurazie Qazim Kalaja	3+1	Kati II
13	Mynyre Ali Gripshi	2+1	Kati III
14	Merita Halil Vrioni	2+1	Kati III
15	Fiqirete Ali Spahia	3+1	Kati III

KONVIKTI 4-KATËSHE SHKOZET, DURRËS

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Struktura	Shënime
1	Pëllumb Ferdinand Shehu	1+1	Kati I
2	Haxhi Lutfi Hoxha	2+1	Kati I
3	Kujtim Besim Berhamaj	1+1	Kati II
4	Miranda Mit'hat Doraci	2+1	Kati II
5	Syrja Ymer Ristani	1+1	Kati III
6	Gjinovefa Mustafa Biçaku	2+1	Kati III
7	Hajri Halil Hasanbelliu	1+1	Kati IV
8	Elmaz Halil Lamçe	2+1	Kati IV
9	Syrja Estref Lame	1+1	Kati I
10	Shuaip Fiqiri Baruti	2+1	Kati I
11	Drita Sadik Kaçi	1+1	Kati II
12	Besnik Sabri Verteniku	2+1	Kati II
13	Ylli Karafil Mançe	1+1	Kati III
14	Skënder Haxhi Merlika	2+1	Kati III
15	Sanije Ahmet Fejzullahu	1+1	Kati IV
16	Ismail Shain Krasniqi	2+1	Kati IV
17	Fatos Ali Salillari	2+1	Kati I
18	Përparim Hysen Gumeni	1+1	Kati I
19	Fejzo Vehip Kuçuku	2+1	Kati I
20	Sadushe Ymer Sinani	2+1	Kati II
21	Ana Orest Donato	1+1	Kati II
22	Hajredin Riza Zeka	2+1	Kati II
23	Tafil Haziz Gërdelli	2+1	Kati III
24	Njazi Isa Toska	1+1	Kati III
25	Shaban Hysen Jakova	2+1	Kati III
26	Nevruz Beqir Çela	2+1	Kati IV
27	Gëzim Shefqet Myftiu	1+1	Kati IV
28	Ahmet Sadik Dakoli	2+1	Kati IV
29	Rexhep Halil Gila	2+1	Kati I

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE



Zonë Kadastrale: 8515 NR. i PASURISE: 5/1530

Vijon në: Vol. _____ Fq. _____ dhe në: Vol. _____ Fq. _____

Indeksi i hartës: DR-H-11

REFUNDIMTARE (data): 04/09/2007

Adresa e pasurisë: Rrethi DURRES Q/F DURRES

Rr/L SHKOZET DURRES P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____

Përshkrim i Veçantë

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: TRUALL Brenda V.K.N.: Jo --> Po. Ref: PL RREG

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Ndëresë
1. _____ m ² Ref _____	1. _____ m ² Ref _____	1. _____ m ² Ref _____
2. 629 m ² Ref LN.04.07	2. 629 m ² Ref LN.04.07	2. _____ m ² Ref _____
3. _____ m ² Ref _____	3. _____ m ² Ref _____	3. _____ m ² Ref _____
4. _____ m ² Ref _____	4. _____ m ² Ref _____	4. _____ m ² Ref _____

Për pjesën e përbandit:

PALLAT

Konta e Pjesëmarrjes:

_____ %

Nr. i Pasurisë (Pallat):


Vol. _____ Fq. _____

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr. Dok	Data Regjistrim	Emri Atësia Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Pagar	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma
		SHTET			DURRES				

Shënim: Kolona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqësues i familjes; B - bashkëpronar (%).

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE,
SERVITUTAVE DHE INTERESAVE TE TJERA




Nr. Dok	Data e Regjistrimit	Përshkrimi	Data e Lësh. të Çertifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj.


Nr. Dok	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. të Çertifikatës	Shënime	Firma
01200	30/05/2007	KUFIZIM	KJO PASURI ESHTË E OKUPIAR NGA BASHKEPRONESI			


SHESHI I NDËRTIMIT
(RIKONSTRUKSIONIT) TË BANESËS PËR TË PËRNDJEKURIT POLITIKË
ME FONDET E SHOQATËS NORVEGJEZE



Tiranë

Durrës





VENDIM
Nr.1078, datë 29.12.2010

PËR AUTORIZIMIN E KURUM INTERNATIONAL, SHA PËR IMPORTIN E MBRETJEVE METALIKE TË HEKURIT DHE ÇELIKUT, PËR QËLLIME RICIKLIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe të nenit 26 të ligjit nr.9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e Kurum International, sh.a., për importin e mbetjeve metalike të hekurit dhe çelikut, me kodin GA 720410, 720429, 720430, 720441, 720449 dhe B1-B1010, të Konventës së Bazelit, anekset 1 e 2 “Mbetjet e listës së gjelbër”, referuar vendimit nr.825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen, për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, për qëllime riciklimi, si më poshtë vijon:

- GA 720410 mbetje dhe kthime të gizës së derdhur;
- GA 720429 mbetje dhe kthime të çelikeve të lidhur;
- GA 720430 mbetje dhe kthime të gizës dhe çelikut të kallajisur;
- GA 720441 copa të vogla, ashkla, feta, mbetje, bluajtje, pluhur sharrimi, pluhur lëmimi, mbetje nga zbukurimet dhe stampimet, nëse janë apo jo në tufë;
- GA 720449 mbetje të fragmentizuara, ashkla.

2. Sasia e mbetjeve metalike të hekurit dhe çelikut, që importohet sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 300 000 (treqind mijë) tonë.

3. Mbetjet importohen nga shteti i Serbisë, duke kaluar transit nëpërmjet shtetit të Malit të Zi. Transporti bëhet në rrugë tokësore, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr.806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin e mbetjeve për përdorim, përpunim dhe riciklim”.

4. Periudha e lejimit të importit të mbetjeve metalike të hekurit dhe çelikut nga Kurum International, sh.a. është nga data 1.1.2011 deri më 1.12.2011.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave të mësipërme ligjore, merr masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve metalike të hekurit dhe çelikut, nga Kurum International, sh.a., pas miratimit të këtij vendimi, për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njeriut.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon, me shkrim, me shtetet eksportuese dhe ato të kalimit transit të kësaj sasive të mbetjeve metalike të hekurit dhe çelikut, në përmbushje të kërkesave të konventës së Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.1065, datë 28.12.2010

**PËR KRITERET E SIPËRFAQEVE QË MUND TË JEPEN NË PËRDORIM PËR
REZERVATE TË MBARËSHTIMIT TË LLOJEVE TË FAUNËS SË EGËR OBJEKT
GJUETIE, DOKUMENTET QË PARAQET KËRKUESI, PROCEDURAT E KONKURRIMIT
DHE RREGULLAT E ADMINISTRIMIT DHE GJUETISË NË KËTO SIPËRFAQE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 5 të nenit 18 të ligjit nr.10 253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”,

UDHËZOJ:

I. Kriteret për sipërfaqet që mund të jepen për mbarështim të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie

Sipërfaqe të fondit pyjor e kullosor jo më pak se 40 ha, nën administrim të drejtorive të shërbimit pyjor, mund të jepen në përdorim për mbarështimin e llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie nëse përmbushin kriteret e mëposhtme:

1. Të jetë sipërfaqe e veshur me bimësi pyjore e kullosore, drurë e shkurre natyrore, e mjaftueshme për të garantuar strehimin dhe ushqimin e llojeve që do të mbarështohen gjatë gjithë vitit, duke pranuar një ushqim plotësues në një periudhë të caktuar të vitit.

2. Të mos jetë në sipërfaqen e njëjës nga kategoritë e mëposhtme të zonave të mbrojtura: rezervatit strikt natyror, parkut kombëtar, monumentit të natyrës.

3. Të mos jetë në sipërfaqen e zonave “Ramsar” apo në zonat ligatinore bregdetare me rëndësi për shpendët migratorë.

4. Të mos jetë në parqet natyrore rajonale.

5. Të mos bjerë në kundërshtim me planet zhvillimore, urbanistike, turistike e industriale.

6. Të mos jetë objekt pretendimi për rikthimin e pronës ish-pronarëve.

II. Kërkesa për të marrë sipërfaqe për mbarështim

1. Për marrjen e sipërfaqes në përdorim për krijimin e rezervateve për mbarështimin e faunës së egër, objekt gjuetie, kërkuesi paraqet pranë drejtorisë së shërbimit pyjor për territorin që ajo administron këto dokumente:

a) kërkesën me gjeneralitetet e kërkuesit (emri, emri i shoqërisë/person juridik/person fizik, adresa, tel/fax/e-mail);

b) kopje të vërtetimit të QKR-së;

c) një përmbledhje të veprimtarisë që do të ushtrohet, së bashku me përshkrimin e zonës;

d) hartën e sipërfaqes në shkallën 1:10000;

e) afatin që do ta përdorë.

2. Për administrimin e kërkesës, DSHP-ja kryen këto procedura:

a) Shqyrton kërkesën dhe përgatit mendimin për përputhshmërinë e saj me kriteret e këtij udhëzimi brenda 10 ditëve pune.

b) Pas shqyrtimit, në rastin kur kërkesa është në përputhje të plotë me kriteret e këtij udhëzimi, DSHP-ja përgatit raportin teknik për sipërfaqen e kërkuar dhe së bashku me mendimin institucional të saj, ia përcjell zyrtarisht Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për shqyrtim të mëtejshëm.

3. Ministria, nëpërmjet drejtorive dhe sektorëve përkatës shqyrton dokumentacionin tekniko-ligjor të ardhur nga DSHP-ja dhe merr vendim mbi bazueshmërinë ligjore të kërkesës, dhe përkatësisht shprehet me shkrim në mënyrë të arsyetuar mbi refuzimin apo pranimin e kërkesës duke ia përcjellë këtë mendim zyrtarisht DSHP-së përkatëse.

4. Në rastin e refuzimit, DSHP-ja njofton zyrtarisht kërkuesin për refuzimin e kërkesës së tij.

5. Në rastin e miratimit, DSHP-ja njofton kërkuesin që sipërfaqja e kërkuar do të shpallet për konkurrim dhe do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe e njeh atë me kërkesat e detajuara për pjesëmarrje në konkurrim.

6. Njoftimi për konkurrim botohet në Buletinin e Njoftimeve Publike në përputhje me rregullat e konkurrimit publik. Njoftimi shpallet 2 herë në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe përmban dokumentacionin që duhet të paraqesin konkurrentët, të dhënat për sipërfaqen, kriteret e konkurrimit dhe pikët vlerësuese për to, si dhe vendin, datën e orën e paraqitjes së dokumentacionit. Data e konkurrimit të jetë jo më parë se 45 ditë kalendrike nga data e botimit të fundit.

7. Në rast se paraqitet një kërkesë e vetme, DSHP-ja rishpall edhe njëherë objektin në konkurrim. Data e konkurrimit në këtë rast të jetë jo më pak se 15 ditë kalendrike nga data e shpalljes. Në rast se edhe pas kësaj rishpalljeje paraqitet një kërkesë e vetme, atëherë DSHP-ja procedon vetëm me këtë kërkesë.

III. Dokumentet e konkurrimit

Për të marrë pjesë në konkurrim, subjektet paraqesin dosjen me këto dokumente:

1. Kërkesën.
2. Vërtetim nga QKR-ja.
3. Projektin teknik të hartuar nga persona të licencuar. Projekti duhet të trajtojë:
 - a) veprimtaritë që sjellin përmirësime të dukshme në mbarështimin e faunës së egër;
 - b) veprimtaritë që përmirësojnë treguesit biologjikë dhe të infrastrukturës në funksion të faunës së egër;
 - c) aktivitetet dhe veprimtaritë që respektojnë kërkesat dhe elementët e nevojshëm për strehim, ushqim, folezim, qetësi etj., të llojeve të faunës së egër objekt gjuetie;
 - d) llojet objekt gjuetie që do të mbarështohen;
 - e) masat për mbrojtjen e faunës nga dëmtuesit, nga kushtet e motit, si dhe të sigurojë kushte për riprodhim;
 - f) programin vjetor të monitorimit të aktivitetit dhe të informacionit;
 - g) masat për ruajtjen në tërësi të objektit nga veprimet e kundërligjshme që shkaktojnë dëmtim të florës dhe faunës së egër;
 - h) planin për organizimin dhe kryerjen e një gjuetie të kontrolluar;
 - i) mënyrat e vjeljes së gjahut në përputhje me kriteret teknike;
 - j) hartën e sipërfaqes me kufij të përcaktuar qartë në shkallë 1:10000 (koordinata gjeografike e metrike);

k) planin për përballimin e emergjencave, zjarre, aksidente dhe fatkeqësi natyrore.

4. Planin e investimeve së bashku me afatet përkatëse.

5. Masën e qirasë për ha/vit, e cila nuk duhet të jetë më e vogël se tarifat në fuqi.

6. Autodeklarimin e kërkuesit, nëpërmjet të cilit ai garanton për vërtetësinë e dokumentacionit që paraqitet, ku përfshihet prezenca e stafit të specializuar për drejtimin dhe realizimin e punimeve të parashikuara në projektin teknik.

7. Vërtetimin nga institucionet bankare që tregon mbi mundësitë financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në masën e 30% të investimit të përgjithshëm.

8. Garanci bankare prej 10% të shumës së qirasë vjetore.

IV. Procedurat e konkurrimit

1. Për të proceduar me konkurrimin, drejtori i DSHP-së nxjerr urdhrin për ngritjen e komisionit të vlerësimit të kërkesave, i cili përbëhet nga jo më pak se pesë anëtarë, specialistë të fushës të DSHP-së përkatëse.

2. Në krye të komisionit të vlerësimit të kërkesave do të jetë drejtori i DSHP-së dhe në përbërje të Komisionit duhet që:

a) një anëtar të jetë me profesion ekonomist; dhe

b) një anëtar të jetë me profesion jurist. Nëse DSHP-ja përkatëse nuk ka jurist në stafin e

saj, drejtori i DSHP-së i bën kërkesë MMPAU-së për autorizimin e një punonjësi me profesion jurist, për të marrë pjesë si anëtar në komision, i cili do të duhet të jetë staf nga drejtoritë e shërbimit pyjor.

3. Komisioni i vlerësimit të kërkesave ka këto detyra:

a) përgatit dokumentacionin për publikim dhe e shpall atë në Buletinin e Njoftimeve Publike;
b) hap, në prani të konkurrentëve, dokumentacionin e paraqitur prej tyre duke bërë të njohur të dhënat kryesore për çdo ofertë të paraqitur. Kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, konkurrenti skualifikohet në prani të tij.

c) harton procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit, ku përshkruan pjesëmarrësit, konkurrentët e skualifikuar dhe shkakun, konkurrentët e kualifikuar dhe listën e dokumenteve të paraqitura prej tyre.

d) brenda 10 ditëve, bën shqyrtimin e ofertave të paraqitura dhe vlerëson me pikë çdo element konkurrimit.

e) rendit në përfundim konkurruesit në bazë të pikëve të përfituara.

f) përgatit, brenda afatit të përcaktuar më lart informacionin për zhvillimin e konkurrimit, së bashku me procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit dhe listën e konkurruesve, të renditur sipas pikëve të fituara.

4. Vlerësimi i ofertës bëhet mbi bazën e kritereve të konkurrimit dhe pikëve të grumbulluara, përcaktuar si më poshtë:

a) projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, 25 pikë;

b) plani i investimeve që do të realizohen, 20 pikë;

c) nivelin e punësimit në veprimtari, 10 pikë;

d) masën e qirasë për ha/vit, 45 pikë.

5. Komisioni vendos për subjektin fitues të konkurrimit. Njoftimi për shpalljen fitues bëhet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe vendoset në këndin e njoftimeve të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, si dhe njëkohësisht kryhet njoftimi zyrtar në MMPAU.

6. Subjektet konkurruese, brenda 7 ditëve nga shpallja e subjektit fitues, kanë të drejtën e ankimit te ministri, i cili brenda 30 ditëve i përgjigjet ankuesit me shkrim.

7. Pas ezaurimit të procedurave të mësipërme administrative, me fituesin lidhet kontrata e qirasë brenda 10 ditëve. Nëse fituesi nuk e lidh kontratën brenda këtij afati, kontrata lidhet me subjektin që është renditur i dyti në listën e konkurrimit. Në këtë rast subjektit të parë i mbahet garancia bankare.

8. Sipërfaqja dorëzohet me procesverbal dhe në përfundim të përdorimit merret në dorëzim nga DSHP-ja po me procesverbal, dhe në të dyja rastet ato mbahen në prani të përfaqësuesve të MMPAU-së.

V. Rregullat e administrimit të rezervatit dhe gjuetisë në këto sipërfaqe

1. Veprimtaria për mbarështimin e faunës së egër në sipërfaqen e kërkuar, rregullohet nëpërmjet kontratës që lidhet me afatin jo më shumë se 10 vjet dhe mbi bazën e kërkesave të legjislacionit në fuqi.

2. Kontrata e qirasë hartohet mbi bazën e kërkesave të Kodit Civil dhe, ndër të tjera, përmban detyrime bazë për qiramarrësin:

a) Për të zbatuar kërkesat teknike, të cilat detajohen në dokumentin e kontratës mbi bazën e dokumentit të projektit teknik që është paraqitur në konkurrim.

b) Për të ruajtur mjedisin nga ndotja dhe dëmtimi që mund të shkaktohet nga veprimtaria.

c) Për të siguruar mbrojtjen nga zjarri dhe faktorë të tjerë natyrorë.

d) Për të informuar me shkrim DSHP-në çdo 6 muaj për ecurinë e veprimtarisë.

e) Kryerjen rregullisht të pagesës së qirasë. Pagesa e parë e qirasë kryhet në momentin e nënshkrimit të kontratës, për periudhën nga momenti i lidhjes së kontratës deri në fund të vitit kalendarik. Për periudhën në vazhdim pagesa e qirasë kryhet në mënyrë të përvitshme dhe paguhet brenda muajit janar të çdo viti.

f) Pagesa e qirasë përfshihet në kontratë dhe është objekt ndryshimi mbi bazën e tarifave të miratuara për fondin pyjor e kullosor.

g) Kushtin që kontrata bëhet e pavlefshme, nëse, gjatë veprimtarisë, sipërfaqja e dhënë në përdorim do të përfshihet në plane rregulluese, turistike, ekonomike e industriale dhe që aktiviteti i mbarështimit të faunës së egër bie në kundërshtim me këto plane. Kontrata bëhet e pavlefshme edhe në rastet kur në sipërfaqen e dhënë në përdorim merren vendime që lidhen mbi statusin e pronësisë, kthimin dhe kompensimin e pronave.

3. Subjekti qiramarrës është përgjegjës për veprimtarinë e administrimit dhe për zhvillimit të gjuetisë brenda territorit.

4. Subjekti qiramarrës përmban regjistra të veçantë për rritjen dhe zhvillimin e llojeve që mbarështohen, si dhe regjistrin e vjeljes së gjahut.

5. Subjekti qiramarrës të marrë masa karantinore për shmangien e sëmundjeve dhe dëmtuesve, të cilët mund të dëmtojnë mbarështimin.

6. Ushqimi shtesë që do të jepet për periudha të veçanta të jetë i kontrolluar, duke iu nënshtruar rregullave higjieno-sanitare.

7. Vjelja të jetë mbështetur në kriteret teknike duke ruajtur vazhdueshmërinë e zhvillimit të llojeve të planifikuara për mbarështimin.

8. Gjatë ushtrimit të vjeljes apo gjuetisë të merren masa për të mos dëmtuar lloje të faunës së egër që nuk janë objekt gjuetie.

9. Të respektohen të gjitha kërkesat e ligjit të gjuetisë dhe aktet nënligjore të lidhura me të.

10. DSHP-ja monitoron në mënyrë të vazhdueshme kontratën dhe zbatimin e projektit teknik dhe gjendjen e sipërfaqes për mbarështim.

11. Gjatë zhvillimit të aktivitetit mund të lejohet vendosja e objekteve ndihmëse për nevoja të mbarështimit të faunës së egër, të cilat pranohen vetëm prej druri.

12. Në përfundim të veprimtarisë, sipërfaqja e dhënë për mbarështim duhet të jetë në përputhje me arritjet e parashikuara në projektin teknik.

VI. Dispozita të fundit

1. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, pika 20 e udhëzimit nr.2, datë 14.5.2009 “Për kriteret e konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor e kullosor”, shfuqizohet.

2. Kërkesat dhe procedurat e këtij udhëzimi mund të përdoren edhe nga njësitë e qeverisjes vendore, kur japin në përdorim sipërfaqe të pyjeve dhe kullotave komunale, për këtë lloj aktiviteti.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtoritë e shërbimit pyjor dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu

VENDIM
Nr.37, datë 24.12.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Bashkim Dedja	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datën 21.9.2010, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.18, akti që i përket:

KËRKUES: Ilmir Hajdari, përfaqësuar nga avokati Përparim Sanxhaku, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr.279, datë 4.6.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31/ç, 34, 42/2, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 290/dh dhe 387/1 të Kodit të Procedurës Penale.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi; përfaqësuesin e kërkuarit që kërkoi pranimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.125, datë 4.5.2005, ka vendosur të deklarojë fajtor të pandehurin Ilmir Hajdari (kërkuesin) për kryerjen e veprave penale të vrasjes së kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 76 e 25 i Kodit Penal, dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal. Në bashkim të dënimeve, bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, kjo gjykatë e ka dënuar kërkuesin me 16 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.44, datë 20.2.2006, ka vendosur të lërë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë në pjesën që ka deklaruar fajtor kërkuesin për kryerjen e veprës penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, dhe ndryshimin e vendimit në pjesën tjetër, duke deklaruar fajtor kërkuesin për kryerjen e veprës penale të vrasjes së kryer në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, parashikuar nga neni 83 i Kodit Penal. Përfundimisht kjo gjykatë, në bashkim të dënimeve, e ka dënuar kërkuesin me 9 vjet burgim.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit kanë ushtruar rekurs prokurori pranë kësaj Gjykate dhe njëri prej të gjykuarve të tjerë, shtetasi XH.SH.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.279, datë 4.6.2008, ka vendosur prishjen e vendimit nr.44, datë 20.2.2006 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe lënien në fuqi të vendimit nr.125, datë 4.5.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me pretendimin se ai është rezultat i një procesi të parregullt ligjor, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe:

- Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e mbrojtjes me avokat, pasi gjykimi është bërë në mungesë të të pandehurit (kërkuesit) dhe mbrojtësit të tij. Shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë është bërë mbi bazën e rekursit të ushtruar nga prokurori dhe një prej të dënuarve të tjerë (XH.SH) dhe, në përfundim të gjykimit, kjo gjykatë ka rënduar pozitën e kërkuesit. Gjykata e Lartë nuk ka zbatuar rregullat e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, pasi rekursi nuk i është njoftuar as kërkuesit dhe as mbrojtësit të tij. Dëftesa e komunikimit të rekursit i është njoftuar babait të kërkuesit, i cili në atë kohë nuk kishte dijeni për vendndodhjen e të birit. Në këto kushte, Gjykata e Lartë duhej të deklaronte ikjen e të gjykuarit dhe t'i caktonte atij mbrojtës kryesisht.

- Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.9678, datë 13.1.2007 "Për dhënie amnistie", dënimi i mbetur për kërkuesin është amnistuar dhe nga institucioni i ekzekutimit të dënimeve është nxjerrë dhe ekzekutuar urdhri i lirimimit për të. Vendimi i Gjykatës së Lartë është marrë në kundërshtim me nenet 290/dh dhe 387/1 të Kodit të Procedurës Penale, pasi dënimi për kërkuesin ishte shuar dhe ishte urdhëruar lirimi i tij me amnisti.

- Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 34 të Kushtetutës (mosgjykimi më shumë se një herë për të njëjtën vepër), pasi në rastin konkret shqyrtimi i çështjes pas shuarjes së dënimit me amnisti është një gjykim që i bëhet sërish çështjes.

II

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) i vlerëson pretendimet e kërkuesit në kuadër të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, dhe konkretisht në këndvështrimin e respektimit të standardit të mbrojtjes me avokat në gjykimin në Gjykatën e Lartë.

1. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së mbrojtjes me avokat

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe, lidhur ngushtë me këto, realizimi i mbrojtjes së të pandehurit, garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së, përbëjnë në vetvete elementet më thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.28, datë 2.10.2009; nr.13, datë 21.7.2008; nr.16, datë 8.6.2006*).

Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale, efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë, jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por dhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar barazinë e armëve (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 26.11.2009; nr.33, datë 24.11.2003; nr.5, datë 17.2.2003*).

Parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve në gjykimin penal kërkon që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe të dëgjohen njëjloj si ato të prokurorit. Ky parim presupozon që secilës palë duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e vënë në disavantazh me palën tjetër (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.5, datë 17.2.2003*).

Për respektimin e këtyre parimeve, Gjykata duhet të përmbushë një sërë detyrimesh, mes të cilave, sipas rasti, rëndësi të veçantë paraqet edhe njoftimi i të pandehurit ose mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes etj., me synimin që të realizohet një debat real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, çka ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe në dhënien e drejtësisë nga gjykata (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 2.4.2009; nr.13, datë 21.7.2008; nr.5, datë 4.3.2008; nr.16, datë 8.6.2006*).

Gjykata ka theksuar se garancitë kushtetuese për një proces të rregullt ligjor duhet të respektohen edhe në gjykimin në Gjykatën e Lartë. Mënyra me të cilën zbatohen këto garanci në gjykimin në këtë Gjykatë varet nga karakteristikat e veçanta të procesit në këtë instancë, në mbajtjen parasysh të tërësisë së procesit dhe në rolin e Gjykatës së Lartë në këtë proces (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 12.6.2003*). Gjykata është shprehur se përgjithësisht seancat

gjyqësore nuk mund të zhvillohen pa praninë e avokatit dhe se pjesëmarrja e të pandehurit në gjykim në Gjykatën e Lartë, duke pasur parasysh se debati zhvillohet për çështje të ligjit, nuk është e domosdoshme, me përjashtim të rasteve kur cilësitë personale të të pandehurit kanë rëndësi vendimtare për dhënien e drejtësisë. Në rast se as avokati, dhe as i pandehuri nuk paraqiten në seancë, është e palejueshme që ajo të vazhdojë. Prezumimi se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në gjykim me vetëdije, mund të justifikohet vetëm nëse atij i është bërë njoftimi personalisht dhe mund të vërtetohet që ai e ka marrë vetë atë. Interesat e drejtësisë kërkojnë detyrimisht realizimin e mbrojtjes, qoftë edhe me avokat të caktuar kryesisht, të të pandehurit që gjykohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, në të cilin, ndër të tjera, kërkohej një rëndim i pozitës së tij në krahasim me vendimin e dhënë për këtë çështje nga Gjykata e Apelit (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 26.11.2009; nr.13, datë 21.7.2008*).

Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se kanë ushtruar rekurs kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër, prokurori pranë kësaj Gjykate dhe i gjykuari XH.SH. Dëftesa e komunikimit të rekursit për kërkuesin Ilmir Hajdari, datë 22.5.2006, rezulton të jetë nënshkruar nga i ati i tij, shtetasi R.H.

Kërkuesi ka paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese urdhër-lirimin nr.60 Prot., datë 30.1.2007, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, nga ku rezulton se bazuar në nenet 1/1 dhe 3/“i” të ligjit nr.9678, datë 13.01.2007 “Për dhënie amnistie”, shtetasi Ilmir Hajdari është liruar nga Institucioni i Ekzekutimit të Dënimeve Penale Burrel më datë 2.2.2007.

Në Gjykatën e Lartë çështja penale në ngarkim të këtyre të gjykuarve ishte njoftuar të zhvillohej në datën 12.3.2008, por në këtë datë gjykimi nuk është zhvilluar, pasi nuk janë paraqitur mbrojtësit e të gjykuarve. Për këto arsye, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur të shtyjë gjykimin e çështjes me shpallje dhe kancelaria e Gjykatës së Lartë i ka dërguar shkresë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për t’u komunikuar rekursin personalisht të pandehurve në burgun ku vuajnë dënimin, duke kërkuar që më pas t’i dërgohen kësaj Gjykate dëftesat e komunikimit. Me shkresën nr.101/66/140 regj., datë 8.5.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër i kthen përgjigje Gjykatës së Lartë, duke i parashtruar shkaqet e mosnënshkrimit të dëftesës së komunikimit nga i pandehuri Ilmir Hajdari. Kështu, dëftesë-komunikimi i datës 17.4.2008, për komunikimin e rekursit, rezulton i panënshkruar nga ky i pandehur dhe në të ndodhet shënimi i të atit “*nuk firmos, djali ndodhet jashtë*”.

Në seancën e datës 14.5.2008 në Gjykatën e Lartë është kërkuar shtyrja e gjykimit për shkak të pamundësisë të paraqitjes së njërit prej mbrojtësve. Në këtë seancë nuk rezulton të jetë paraqitur mbrojtësi i kërkuesit. Në seancën e datës 28.5.2008, në të cilën janë shqyrtuar rekursat e paraqitura nga palët (prokurori dhe i pandehuri Xh.Sh), nuk është paraqitur as kërkuesi, dhe as mbrojtësi i tij dhe Gjykata e Lartë ka zhvilluar gjykimin në mungesë të tyre.

Në përfundim të gjykimit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, Kolegji Penal i kësaj Gjykate, me vendimin e tij, ka ndryshuar *in peus* cilësimin ligjor të veprës penale, si dhe masën e dënimit të dhënë nga Gjykata e Apelit për kërkuesin, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër që parashikonte një masë më të rëndë dënimi për të.

Gjykata vlerëson se, nisur nga specifika e rastit në shqyrtim, ku çështja është gjykuar edhe mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, i cili ka ngritur kryesisht pretendime lidhur me kërkuesin, çka sillte potencialisht mundësinë e rëndimit të pozitës së këtij të fundit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk duhej të zhvillonte gjykimin pa i dhënë mundësi palës së akuzuar (kërkuesit) të realizonte mbrojtjen ligjore. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë dilte e domosdoshme marrja e masave, në mënyrë që të mos lejonte zhvillimin e seancës në mungesë të përfaqësuesit të kërkuesit, sepse ishte e vetmja mënyrë që ai, përmes figurës përfaqësuese të avokatit, të realizonte të drejtën për t’u mbrojtur.

Si pasojë, Gjykata vlerëson se, në rastin në shqyrtim, Gjykata e Lartë nuk ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor nga pikëpamja kushtetuese.

2. Lidhur me pretendimin se Gjykata e Lartë duhet të pushonte çështjen penale

Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se Gjykata e Lartë, bazuar në nenet 290/“dh” dhe 387/1 të Kodit të Procedurës Penale, duhej të vendoste pushimin e çështjes, pasi dënimi për kërkuesin ishte amnistuar dhe ishte urdhëruar lirimi i tij.

Gjykata me këtë rast rithekson se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve të gjykatave të zakonshme është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Interpretimi dhe zbatimi i ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.22, datë 22.7.2009; nr.31, datë 1.12.2005*).

Përsa i përket këtij pretendimi, Gjykata vlerëson se në thelb ai ka të bëjë me mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (Gjykata e Lartë) dhe në këto kushte nuk mund të merret në shqyrtim nga kjo Gjykatë.

3. Lidhur me pretendimin e shkeljes së nenit 34 të Kushtetutës (ndalimi i gjykimit më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale)

Kërkuesi pretendon edhe se Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim me nenin 34 të Kushtetutës, pasi në rastin konkret shqyrtimi i çështjes pas shuarjes së dënimit me amnisti është një gjykim që i bëhet sërish çështjes.

Me këtë rast Gjykata thekson se një ankesë kushtetuese jo vetëm duhet t'i referohet një dispozite kushtetuese, por duhet edhe të argumentojë se ku qëndron shkelja e kësaj dispozite. Lidhur me këtë pretendim konstatohet se kërkuesi as në kërkesë, dhe as gjatë gjykimit, nuk arriti të argumentojë se ku qëndron shkelja e ndalimit kushtetues të gjykimit më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale. Vetëm referimi në një dispozitë kushtetuese, pa dhënë arsyet e shkeljes së saj, nuk është i mjaftueshëm për të konstatuar një shkelje.

Për pasojë, edhe ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim nga kjo Gjykatë.

Përsa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se në tërësinë e tij procesi gjyqësor i zhvilluar në Gjykatën e Lartë, në aspektin kushtetues, ka qenë i parregullt, pasi kërkuesit i është cenuar e drejta e mbrojtjes me avokat në këtë gjykatë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131 shkronja “f” dhe 134 pika 1 shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës, duke shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë vendimin nr.279, datë 4.6.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, përsa i përket të gjykuarit Ilmir Hajdari.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar) Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Admir Thanza, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Petrit Pllloçi, Altina Xhoxhaj, Bashkim Dedja

VENDIM
Nr.38, datë 30.12.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Pllloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Bashkim Dedja	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datë 21.7.2010 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.10 Akti që i përket:

KËRKUES: Luan Perati, përfaqësuar nga avokat Rustem Gjata, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve: nr.356, datë 28.6.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr.439, datë 3.12.2007 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr.518, datë 16.10.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f dhe 134/g e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vitore Tusha; kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës; subjektin e interesuar që në pretendimet e depozituara me shkrim, është shprehur për rrëzimin e saj dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesi Luan Perati ka blerë një mjet tip Benz 250 D, me targa italiane, fakt i cili provohet nga kontrata e shitblerjes së automjetit, nr.1569 Rep., nr.902 Kol., datë 15.5.2002, e nënshkruar përpara noterit. Gjatë një kontrolli të policisë për verifikimin e dokumentacionit të mjeteve është konstatuar se leja e qarkullimit të mjetit të kërkuesit, me nr.124788, i përkiste automjetit me nr.shasie WDB1241251A160355, ndërsa automjeti në përdorim të kërkuesit kishte numër shasie WBD1241251B227052. Nga verifikimet ka rezultuar se për mjetin tip “Benz” me numër shasie WDB1241251A160355, kërkuesi kishte paguar detyrimin doganor dhe ky mjet ishte regjistruar njëkohësisht në qytetin e Durrësit dhe të Fierit.

Prokuroria e Rrethit Durrës ka filluar procedimin penal kundër shtetasit Luan Perati për kryerjen e veprës penale “të falsifikimit të formularëve në formën e përdorimit”, parashikuar nga neni 190/1 i Kodit Penal (KP).

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.356, datë 28.6.2006, ka deklaruar kërkuesin fajtor për kryerjen e veprës penale “të falsifikimit të formularëve në formën e përdorimit” dhe në bazë të nenit 190, paragrafi i parë i KP-së (i pandryshuar), e ka dënuar me gjobë në shumën prej 270 000 lekë. Duke qenë se kërkuesi dhe mbrojtësi i tij kanë kërkuar të procedohet me gjykim

të shkurtuar, gjykata, në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ka vendosur uljen e dënimit me 1/3 dhe e ka dënuar përfundimisht kërkuesin me 180 000 lekë gjobë.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.439, datë 3.12.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal nr.356, datë 28.6.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke mosaplikuar nenin 406 të KPP-së.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, me vendimin nr.00-2009-226(518), datë 16.10.2009, ka vendosur mospranimin e rekursit pasi nuk plotësonte kërkesat e nenit 435/2 të KPP-së.

Kërkuesi, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, pretendon cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor duke parashtruar si vijon:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykata e Apelit Durrës nuk kanë respektuar kërkesat ligjore dhe kushtetuese për arsyetimin e vendimit.

- Gjykata e Apelit nuk ka respektuar parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, pasi gjatë gjykimit nuk janë pranuar kërkesat për marrjen e provave dhe vlerësimin e tyre, të cilat paraqisnin rëndësi për çështjen dhe vërtetimin e pafajësisë së kërkuesit.

- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka mohuar kërkuesit të drejtën për t'u dëgjuar për shkaqet e ngritura në recurs, për shkak të nënshkrimit të rekursit vetëm prej tij dhe jo nga ana e mbrojtësit, i cili në të vërtetë e kishte redaktuar atë.

Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka parashtruar me shkrim këto prapësime:

- Pretendimet e kërkuesit nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese, pasi paraqitja e një rekursi të panëshkruar në Gjykatën e Lartë nuk mund të konsiderohet si shterim i të gjitha mundësive ligjore për t'u ankuar kundër vendimeve gjyqësore të kundërshtuara. Ankimet që nuk respektojnë afatin e paraqitjes ose nuk janë të nënshkruara rregullisht siç kërkon ligji procedural, në aspektin e pasojave juridike që prodhon kjo parregullsi, duhen konsideruar si raste të mosushtrimit të mjetit përkatës të ankimit.

- Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë, si rezultat i mosnënshkrimit të rekursit nga mbrojtësi, është i pabazuar pasi kjo është kërkesë ligjore e nenit 435, pika 2 të KPP-së.

- Kërkuesi nuk ka ngritur pretendime për kushtetutshmërinë e nenit 435, pika 2 të KPP-së, e, për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese nuk mund të zgjerojë kryesisht objektin e gjykimit.

II

1. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Durrës

Kërkuesi ka pretenduar se, për shkak të mosrespektimit të rregullave procedurale për marrjen dhe vlerësimin e provave, gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Durrës është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka trajtuar në mënyrë të vazhdueshme rëndësinë e respektimit të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit në gjykimin penal, duke ritheksuar se, veçanërisht në procesin penal, këto parime dhe lidhur ngushtë me to, mbrojtja e të pandehurit, e garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor. Këto standarde kushtetuese kërkojnë që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe të dëgjohen ashtu si ato të prokurorit. Këto parime presupozojnë që secilës palë duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme, për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e venë në disavantazh me palën tjetër. Synim kryesor i këtyre parimeve është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, çka ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e të vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.13, datë 21.7.2008; nr.19, datë 18.9.2008, nr.10, datë 2.4.2009 nr.23, datë 23.7.2009*).

Në lidhje me thirrjen e dëshmitarëve në procesin penal, kjo Gjykatë ka theksuar se refuzimi i kërkesës së mbrojtësit për thirrjen e tyre, me qëllim bërjen e pyetjeve për të kundërshtuar provën në procesin penal, cenon të drejtën e mbrojtjes të të akuzuarit, çka vjen ndesh me kërkesat e nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6, paragrafët 1 e 3, shkronja "d" të KEDNJ-së (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.7, datë 27.4.2005*).

Edhe GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj, midis të tjerash, është shprehur se në kuptim të nenit 6, paragrafi 3, shkronja "d" të KEDNJ-së, çdo i akuzuar për kryerjen e veprës së dënueshme penale ka të drejtë "të marrë në pyetje ose të kërkojë të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës, si dhe të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes në kushte të njëjta me ata të akuzës". Megjithatë, nuk mjafton që i akuzuari të tregojë se i është mohuar mundësia t'u drejtojë pyetje disave prej dëshmitarëve, por duhet, përveç kësaj, të bëjë të besueshme se këto pyetje ishin të domosdoshme për të përcaktuar të vërtetën dhe se ky mosveprim i kishte cenuar të drejtën për t'u mbrojtur. Nëse gjykatat e zakonshme vërejnë se dëshmia nuk do të kishte rëndësi për gjykimin, ato mund ta refuzojnë kërkesën për marrjen në pyetje të dëshmitarit, por duhet që një gjë të tillë ta arsyetojnë. Kjo nuk bëhet për të siguruar vetëm respektimin e barazisë së armëve, por dhe të parimit të kontradiktoritetit të gjykimit ose të shqyrtimit të provave (*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Emmanuello kundër Italisë, datë 31.08.1999; Vidal kundër Belgjikës, datë 22.04.1992; Caka kundër Shqipërisë, datë 8.3.2010*).

Duke e vlerësuar pretendimin e kërkuarit në këndvështrim të standardeve të mësipërme të procesit të rregullt ligjor, si dhe nga analiza e dosjes gjyqësore të administruar, Gjykata konstaton se kërkuarit i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të mosgarantimit të standardit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Durrës.

Gjykata konstaton se sipas procesverbalit gjyqësor të datës 12.4.2007, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur të pranojë kërkesën e mbrojtësit, për të përsëritur pjesërisht shqyrtimin gjyqësor, për të thirrur me cilësinë e dëshmitarit shtetasin V.P., si dhe për të paraqitur prova të tjera që kanë rëndësi për çështjen. Gjykata ka ngarkuar mbrojtësin e të pandehurit për njoftimin e dëshmitarit, gjë që sipas procesverbalit të datës 9.5.2007, ka rezultuar e pamundur për shkak të mosgjjetjes të adresës së tij. Gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore, duke i dhënë mbrojtësit përsëri kohë për njoftimin e dëshmitarit. Në seancën e datës 4.7.2007, mbrojtësi i të pandehurit ka deklaruar se ka qenë e pamundur gjetja e adresës së saktë të dëshmitarit V.P., pasi si tregtar makinash ai vinte në portin e Durrësit një herë në muaj. Gjykata e Apelit Durrës, mbi kërkesën e prokurorit, ka revokuar vendimin për thirrjen e dëshmitarit V.P. dhe ka shtyrë seancën gjyqësore për të proceduar me thirrjen e ekspertit që do të verifikonte nëse nënshkrimi në deklaratën doganore ishte i njëjtë me atë të kërkuarit.

Gjykata vlerëson se në procesin penal të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Durrës nuk janë respektuar kërkesat e KPP-së (nenet 132 - 143) për njoftimin e dëshmitarit të kërkuar nga mbrojtësi i të pandehurit. Gjykata e Apelit Durrës ka ngarkuar mbrojtësin e të pandehurit për njoftimin e dëshmitarit V.P., ndërkohë që, sipas nenit 132 të KPP-së, njoftimi i dëshmitarëve përbën një detyrim për gjykatën. Në rast se njoftimi do të rezultonte i pamundur, atëherë gjykata, në zbatim edhe të nenit 164 të KPP-së, duhet të kishte marrë të gjitha masat për shoqërimin e detyrueshëm të këtij dëshmitari.

Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se revokimi i thirrjes së dëshmitarit të kërkuar nga mbrojtësi, nuk është rezultat i vlerësimit mbi parëndësinë e këtij dëshmitari në procesin penal, por është pasojë e shkeljes së detyrimit të Gjykatës së Apelit Durrës për thirrjen e tij, në vështrim të neneve 132 dhe 164 të KPP-së. Në këtë vështrim, Gjykata arrin në konkluzionin se gjatë gjykimit të çështjes janë cenuar standardet e procesit të rregullt ligjor, parashikuar nga nenet 31/d dhe 42 të Kushtetutës, duke i mohuar kërkuarit mundësinë e arsyeshme për të paraqitur dhe ballafaquar pretendimet e tij për veprimet e kryera nga dëshmitari V.P., çka ka sjellë pamundësinë e tij për t'u mbrojtur ndaj akuzave të prokurorit.

2. Në lidhje me pretendimin për mosarsyetimin e vendimit

Gjykata konstaton se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës nuk ka respektuar kërkesat e neneve 42 dhe 142/1 të Kushtetutës që parashikojnë detyrimin për arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 7, datë 9.3.2009 dhe nr.23, datë 23.7.2009*).

Gjykata, konstaton se në dosjen gjyqësore gjenden dokumente, analiza e të cilave nuk gjen pasqyrim në vendimin e Gjykatës së Apelit, të tilla si kontrata nr.1569 Rep., nr.902 Kol., datë 15.4.2002, e redaktuar para noterit, deklarata e shitjes e hartuar nga shtetasi/dëshmitari V.P., si dhe kontrata e shitblerjes nr.1899 Rep., nr.1206 Kol, datë 28.6.2002.

Sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës nuk pasqyron tërësinë e fakteve/ngjarjeve ashtu siç janë administruar në gjykim dhe as mënyrën mbi bazën e të cilës janë analizuar dhe vlerësuar provat që kundërshtojnë njëra-tjetrën.

Në këto kushte, Gjykata vlerëson se në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Apelit Durrës nuk është respektuar një nga standardet e procesit të rregullt ligjor lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore, çka ndikon dhe në cenimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

3. Në lidhje me pretendimin për cenimin e aksesit në Gjykatën e Lartë

Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se mungesa e nënshkrimit të mbrojtësit, në rekursin e ushtruar prej tij, nuk mund të sjellë detyrimisht mohimin e të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje mbi shkaqet e ngritura në rekurs.

Gjykata është shprehur në jurisprudencën e saj se procesi i rregullt ligjor ka si element përbërës, midis të tjerash, edhe të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, lidhur me pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 3.6.2009*).

E drejta për t'iu drejtuar një gjykate nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë pjesë e kufizimeve (veçanërisht lidhur me kushtet e pranimit të një apelimi), por kufizimet nuk duhet të jenë të tilla sa të dëmtojnë vetë thelbin e të drejtës. Ato duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe mjetet e përdorura duhet të jenë përpjesëtimore me qëllimin që kërkohet të arrihet (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 17.6.2010*).

Gjykata është shprehur, gjithashtu, se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes, në formë e në përmbajtje, siç sanksionohet në KPP, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e të drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Mostrajtimi i mjetit procedural në mënyrë substanciale cenon të drejtën e mbrojtjes të të gjykuarit dhe njëkohësisht aksesin e tij në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.21, datë 24.7.2006*). Gjithashtu, zbatimi i gabuar i normave të KPP-së, që ka sjellë mosgjykimin e thelbit të

pretendimeve të kërkuarit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i ka mohuar atij të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës, si element thelbësor i të drejtës për proces të rregullt ligjor (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.16, datë 19.4.2010*).

Po ashtu, Gjykata ka theksuar se nisur nga natyra e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe të përqendrimit (kompetencës) të saj në probleme të ligjit, pa ndihmën e një avokati, procesi nuk mund të kontribuojë në mënyrë të dobishme në shqyrtimin e çështjeve juridike që qëndrojnë në thelb të mosmarrëveshjeve (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.25, datë 30.7.2003*). Për më tepër, përfaqësimi me avokat në seancat dëgjimore në Gjykatën e Lartë bëhet i domosdoshëm për garantimin në favor të të pandehurit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.5, datë 4.3.2008*).

Edhe GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj është shprehur se fakti që aplikanti ishte në gjendje të paraqiste çështjen e tij përpara një gjykate nuk përmbush domosdoshmërisht në vetvete kërkesat e nenit 6 § 1 të KEDNJ-së. Rregullat që dispijlojnë hapat formalë që duhen ndërmarrë për paraqitjen e një ankimi synojnë të sigurojnë miradministrimin e drejtësisë. Nga ana tjetër, është kërkesë e nenit 6/1 të KEDNJ-së, që mospranimi i një ankimi në Gjykatën e Lartë të mos cenojë thelbin e të drejtës së ankimesit për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Société Anonyme Sotiris dhe Nikos Koutras Attee kundër Greqisë, datë 16.11.2001; Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës, datë 19.12.1997, Saez Maeso kundër Spanjës, datë 9.11.2004*).

Gjykata konstaton se në rastin konkret, kërkuari ka depozituar brenda afatit ligjor, pranë sekretarisë së gjykatës që ka dhënë vendimin, një rekurs, të nënshkruar prej tij, i cili në pjesën hyrëse përmban ndër të tjera se është akt i Kolegjit të Avokatëve Durrës, por nuk rezulton i nënshkruar nga mbrojtësi që e ka redaktuar atë. Kolegji Penal, në Dhomë Këshillimi, me vendimin nr.518, datë 16.10.2009, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke u bazuar në mosplotësimin e kërkesave të nenit 435/2 të KPP-së, i cili parashikon: "*Akti i rekursit dhe memoriet duhen të nënshkruhen, me pasojë mospranimin, nga mbrojtësit. Kur i pandehuri nuk ka mbrojtës të zgjedhur, kryetari i kolegjit cakton një mbrojtës kryesisht dhe në këtë rast lajmërimet i bëhen edhe të pandehurit.*"

Nga rrethanat e parashtruara më sipër dhe në vështrim të garantimit të standardit të aksesit në gjykatë, Gjykata vlerëson se neni 435/2 i KPP-së, nuk mund të interpretohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në një mënyrë të tillë (kuptim i ngushtë), që cenon thelbin e të drejtës së një individi për t'iu drejtuar asaj gjykate.

Mbrojtja me avokat e të pandehurit, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, bazuar në nenin 437, pikat 3 dhe 5 të KPP-së, është vlerësuar nga Gjykata si kërkesë e nevojshme në funksion të garantimit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale që është në interes të drejtësisë. Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se edhe neni 435/2 i KPP-së, i cili parashikon se rekursi dhe memoriet që i drejtohen Gjykatës së Lartë duhen të nënshkruhen nga mbrojtësit e të pandehurve, ka për qëllim të garantojë mbrojtjen me avokat të të pandehurit, në rastin kur ai ushtron rekurs. Standardi i mbrojtjes me avokat në Gjykatën e Lartë nuk garantohet plotësisht nëse respektohet vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor. Rekursi është akti procedural në të cilin parashtrihen shkaqet për të cilat kundërshtohet një vendim sipas kërkesave të nenit 432 të KPP-së, që mundëson të drejtën e të pandehurit për të filluar gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin garantohet e drejta për akses në këtë gjykatë. Kërkesa kushtetuese dhe procedurale për të garantuar mbrojtjen efektive dhe profesionale të të pandehurit në Gjykatën e Lartë, ka kuptim, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të ushtruar të drejtat që parashikon procedura penale. Qëllimin e ligjvënësit, për të garantuar mbrojtës në këtë proces, e shpreh edhe detyrimi që kjo normë i ngarkon kryetarit të kolegjit, për të caktuar një mbrojtës kryesisht për të pandehurin, i cili nuk ka mbrojtës të zgjedhur.

Për të garantuar të drejtën e një individi për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë, zbatimi i nenit 435/2 të KPP-së duhet parë në raport me rregullimet e përgjithshme që dispijlojnë paraqitjen e ankimit (nenet 407- 421 të KPP-së), si dhe ato të veçanta për paraqitjen e rekursit (nenet 431-435 të KPP-së). Në situatën në të cilën kërkuari ka ushtruar rekursin, në përmbushje të detyrimeve të tij

formalë që përcaktohen kryesisht në nenet 410, 412, 420, 435/1 të KPP-së dhe rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij, ai nuk mund të privohet nga e drejta që rekursi i tij të vlerësohet sipas përcaktimeve të nenit 432 të KPP-së. Një interpretim i ndryshëm, që mund t'i bëhet përmbajtjes së nenit 435/2 të KPP-së, nuk i shërben rritjes së standardit në favor të garancive për të mos humbur të drejtën e gjykimit, përkundrazi sjell si pasojë cenimin e të drejtës së të pandehurit për akses në Gjykatën e Lartë.

Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë para se të vendosë mospranimin e rekursit, për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, duhet të verifikojë nëse sekretaria gjyqësore ka zbatuar detyrimin ligjor lidhur me vënien në dijeni të të pandehurit, për të plotësuar rekursin me nënshkrimin nga mbrojtësi, sipas kuptimit që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr.5, datë 15.9.2009, i kanë dhënë nenit 415/2 të KPP-së, duke u shprehur se: *“Sekretariteti e gjykatave ku depozitohet ankimi mund dhe duhet të vënë në dijeni të pandehurit në rastet kur rekursi paraqitet i panënshkruar nga mbrojtësi, me qëllim që, në zbatim të kërkesave të nenit 415/2 të KPP, ai të ketë mundësinë për plotësimin e tij”*. Gjithashtu, në rastin kur i pandehuri nuk ka mbrojtës të tij, Gjykata e Lartë duhet të verifikojë nëse kryetari i kolegjit e ka përmbushur detyrimin e tij për të caktuar avokat kryesisht. Këto kërkesa ligjore kanë rëndësi kushtetuese, sepse garantojnë realisht të drejtën e individit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë.

Si përfundim, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi), duke vendosur mospranimin e shqyrtimit të rekursit të panënshkruar nga mbrojtësi, nuk ka respektuar të drejtën e aksesit në gjykatë, si një nga standardet për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ.

4. Në lidhje me pretendimet e tjera

Kërkuesi ka kërkuar, gjithashtu, shfuqizimin e vendimit nr.356, datë 28.6.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me pretendimin se procesi gjyqësor ka qenë i parregullt. Gjykata vlerëson se argumentet e parashtruara në lidhje me këtë pretendim nuk janë ngritur në nivel kushtetues dhe, për rrjedhojë, duhen rrëzuar si të pabazuara.

Përfundimisht, Gjykata arrin në konkluzionin se gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, kërkuesit Luan Perati i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “a” dhe nenit 134, pika 1 shkronja “f”, të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr.518, datë 16.10.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).
- Shfuqizimin e vendimit nr.439, datë 3.12.2007 të Gjykatës së Apelit Durrës.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Durrës.
- Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e vendimit nr.356, datë 28.6.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Petrit Pllaçi, Xhezair Zaganjori, Admir Thanza, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Bashkim Dedaj, Altina Xhoxhaj

VENDIM
(I shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.3198, datë 7.12.2010, ka vendosur shpalljen të zhdukur të shtetasit Lulzim Tabaku, i datëlindjes 27.2.1973, lindur dhe banues në Durrës.

KËRKESË

Shtetasi Bardhyl Emin Xherahi, i datëlindjes 26.12.1955, lindur dhe banues në Tiranë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shpalljen të vdekur të vëllait të tij, shtetasit Alfred Emin Xherahi, i datëlindjes 2.4.1963.

KËRKUESI
Bardhyl Xherahi

Njoftojmë se kanë filluar abonimet për vitin 2011 për Fletoren Zyrtare.

Afati i abonimit mbaron më 31.1.2011.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 7.1.2011

Doli nga shtypi më 9.1.2011

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë